REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK/DHP Nr. Prot. 03-1773/13
Nr. Faq. 01 Data 06.06.2013
PRISHTINË

Regj.nr. 10173/12

**GJYKATA THEMELORE, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN**, përmes gjyqtares Luljete Shabani, me Sekretaren Juridike Remzije Munishi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit Ibish Ibishi nga fsh. Doberqan, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 dhe 9 te Ligjit nr.04/L-050 per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publike dhe Deklarimin, Prejardhejen dhe Kontrollin e Dhuratve dhe Kontrollin e Dhuratvae per te gjithe Personat Zyrtareve, te sanksionuar me nenin 17, p;ar.1.3 te Ligjit nr.04/L-50, e në bazë të nenit 73,195 të Ligjit mbi kundërvajtjet me datë 22.05.2012, mori këtë

**A K T V E N D I M**

I pandehuri Ibish Xhavit Ibishi, i lindur më 05.05.1968, në fsh. Suharne, jeton, ne fsh.Doberqan, K.e Gjilanit, shqiptar, shtetas i Kosovës, keshilltar ne Kuvendin Komunal ne Gjilan, laborant ne Spitalin Regjonal ne Gjilan, i martuar, baba i dy fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike ,

**Ë SH T Ë  P Ë R G J E G J Ë S**

. Sepse, nuk e ka permbushur obligimin ligjor per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave per te gjithe Personat Zyertare per vitin 2012,

-me çka ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni 5,6, paragarfi ,3 dhe neni 9 te Ligjit per Deklarimin, Prejardhjejn dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te larte Publike dhe Deklarimin, Prejardhejn dhe Kontrollin e Dhuratave per te Gjithe Personat Zyrtare, andaj,

**D Ë N O H E T**

**ME DËNIM GJOBE** në shumë prej **1000 (njemije) €,** të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën dënimi i paraparë me burg do të zëvëndësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, që do të thotë, një ditë burgu, 15 €

Obligohet i pndehuri që në afat të njëjtë si edhe dënimin, t'i paguajë kësaj Gjykate shumën prej **10 (dhjetë) €**, në bazë të nenit 109 të LMK

**A r s y e t i m**

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë,, me kërkesën nr. 01-2355/12, të dt. 02.07.2012, ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedura kundërvajtëse.

Gjykatësja shqyrtoi kërkesën e bërë dhe gjeti se e njejta është e bazuar në Lijg.

I pandehuri, në këtë gjykatë pjesërisht e pranoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, duke thenë se vërtetë ai ne vitin 2012 nuk e ka bere deklarimin e Pasurise, por, u arsyetua se faji ka qene te Agjencia Kunder Korrupcion, e cila nuk u ka derguar fare formularet, ndersa, per vitin 2013, meqe u ka ne ardhur formularet e permendur, ky me kohe e plotesuar ate dhe e ka derguar ne AKK.

Per verteimin me te mire te gjendjes faktike, gjykatesaj mori ne pyetje dy deshmitare, Enis Sadiku, Mbikqyres i Larte ne AKK dhe, Agush Nuhiu, Zyrtar Kontaktues per Zyrtaret e Lartet e Komunes se Gjilanit.

Deshmitari Enis Sadiku, Mbikqyres i Larte ne AKK, deklaroi se ata nuk kontaktojne me secilin zyrtare te Larte, por, i kane Pikat Kontaktuese, e ne kete rast, personi Kontaktues eshte Agush Nuhiu, i cili e ka per detyre t'i njohtoje Zyrtaret e Lartet e Komunnes se Gjilanit per detyrimet e tyre per deklarimin e pasurise, ndersa, nuk e ka per obligim t'i furnizoje zyrtaret me, formulare. Ai shtoi se meqe nuk mund t'a dine se a i ka njoftuar personi kontaktues, eshte mire qe te mirret ne pyetje ai.

Personi Kontaktues i AKK, Agush Nuhiu deklaroi se me pergjegjesi te plote thote se ky secilit keshilltar komunal, veç e veç ua ka derguar formularet per deklarimin e Pasurise, nje muaj para afatit te duhur per deklarimin e pasurise dhe nuk qendrojne fjalet e te pandehuit Ibish se gjoja nuk eshte furnizuar me formulare, bile ky ne selite e seciles parti politike i ka shperndare ato, pasi qe kjo ka qene forma e njoftimit per vitin 2012, ndersa, per vitin 2013 ka qene forme tjeter , at vete eshte dashur t'i shkarkojne nga faqja e internetit dhe pasi i kane plotesuar, ia kane sjellur ketij per t'i derguar ne AKK ne Prishtine.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ku janë deklaratat e te pandehurit si dhe deklaratat e dy deshmitareve, gjykatesja erdhi ne perfundim se i pandehuri e ka kryer vepren kundervajtese qe i vihet ne barre, andaj, e denoi si ne dispozitiv te ketij aktvendimi, duke qene e bindur se edhe keshtu do te ndikohet tek ai qe ne te ardhmen mos te perserise vepra te tilla kundervajtese.

Mësa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GYKATA THEMELORE, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN**
**më datë 22.05.2013**

**Sekretarja Jurike,**
**Remzije Munishi**

**Gjyqtarja,**
**Luljete Shabani**

***UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:*** *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit, Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.Ankesa dorezohet përmes kësaj gjykate*